



RE PUBL IKA E SH Q I P Ë R I S Ë  
KËSHILLI I MINISTR AVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

“PËR OBJEKTIN GODINA REZIDENCIALE TE KAMPUSIT UNIVERSITAR ME 4-5-6  
KATE MBI TOKE DHE 2-3 KATE NEN TOKE”



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKA

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 16, Date 14.12.2022

Projektues:

Ricardo Bofill, Taller de Arquitectura,  
Kristi Tashi PF

Zhvillues:

Artan Dumi  
Mirela Papuli

## TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

### 1. Dispozita të Përgjithshme

- 1.1 Baza Ligjore
- 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

### 2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

- 2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së
- 2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

### 3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese

### 4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

- 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara
- 4.2 Shperndarja e kateve
- 4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave
- 4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit
- 4.5 Hapësirat e lira dhe të gjelbërtë / vendparkimet

### 5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

- 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave



Kml

## 1. Dispozita të Përgjithshme

### 1.1 Baza Ligjore

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Ndertimit për objektin: **“GODINA REZIDENCIALE TE KAMPUSIT UNIVERSITAR ME 4-5-6 KATE MBI TOKE DHE 2-3 KATE NEN TOKE”**, Bashkia Tirane, me zhvillues Z.Artan Dumi dhe Znj. Mirela Papuli bazuar në:

- Ligji nr.107/2014,dt.31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.
- VKM nr. 408,dt.13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar.
- Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë i miratuar me Vendimin nr.1 , dt 14.04.2017 e ndryshuar.

### 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

Parcela e propozuar për zhvillim, gjendet brenda unazës së madhe të qytetit, prane në një zonë e cila është formuar kryesisht pas viteve 90.

Sheshi ku do të ndërtohet objekti i sipërcituar ndodhet në Qytetin e Tiranës, kufizohet me rrugen “Haxhi Dushku” ne krahun veriperendimor, me rrugen e Elbasanit ne krahun verilindor dhe pa rrugë te ndertuara ne anet juglindore dhe jugperendimore. Sheshi eshte rreth 5 km larg në vijë të drejtë me qendrën e Tiranës dhe 1.2 km ne vije te drejte me Terminalin Lindor te Autobusave te Tiranës. Sheshi ndodhet në Njësinë Strukturore FA/91, të PPV-së Bashkia Tiranë. Sheshi ndodhet në njësinë bashkiake Farkë, zona kadastrale 2704 dhe ka një sipërfaqe prej 38814 m<sup>2</sup>.

Zona ku ndodhet sheshi karakterizohet nga objekte të ulëta 1,2,3 dhe disa objekte 4 kate. Këto objekte janë ndërtuar kryesisht pas viteve 90. Vitet e fundit zona ka marrë zhvillim me ndërtime te reja bashkëkohore me funksion banim dhe shërbime, të miratuar sipas PPV-së ,Bashkia Tiranë. Disa objekte në distanë jo të largët tashmë kanë përfunduar si dhe priten në vijim të tjera, duke shtuar aktivitetin në këtë pjesë të qytetit.

Sheshi ndodhet në një zonë me infrastrukturë kryesisht të formuar, përsa i përket infrastrukturës së ujësjellës-kanalizime, furnizimit me energji elektrike, gjë që favorizon në furnizimin me ujë dhe me energji elektrike të ndërtimit të propozuar.

Sheshi ka pozicion të favorshëm, ndihmuar edhe nga fakti që është drejtpërsedrejt i aksesueshem nga rruga “Haxhi Dushku”, nga “Ruga e Elbasanit” dhe autostrada Tirane-Elbasan. Ky shesh ka një sipërfaqe prej 38814 m<sup>2</sup>. Ai kufizohet ne verilindje nga “Ruga e Elbasanit”, ne juglindje nga autostrada Tirane-Elbasan dhe ne veriperëndim nga rruga “Haxhi Dushku”. Terreni eshte i pjerret, me diferenca te theksuara kuotash.






Fig.01 Lidhja e Sheshit të ndërtimit me Qendrën e qytetit



Fig.02 Vendndodhja e Sheshit ku propozohet Objekti i ri



K

## 2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

### 2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së

Duke u bazuar në rregulloren e Planit të përgjithshëm vendor të bashkise së Tiranës 2030, të miratuar pranë Keshillit Kombëtar të Territorit, me Vendim Nr. 2, date 27.07.2022 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tirane", objekti i propozuar gjendet në hapësirën e konturuar brenda Njësisë Strukturore FA/91. Referuar pasaportës së zhvillimit të miratuar dhe në zbatim nga Bashkia Tiranë, përdorimi i tokës sipas kategorisë bazë i lejuara në këtë Njësi Strukturore është Banim (A).

Referuar sa me sipër, përdorimi i tokës për funksion "Banim" në këtë Njësi Strukturore përfshihet në kategorinë e përdorimeve të lejuara.

### 2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

Më poshtë paraqitet fragmenti i hartave të PPV-së bashkia Tiranë, ku jepet edhe pozicioni i objektit të propozuar në zonën e interesit FA/91.




Fig.03 Fragment i hartës së Njësive Strukturore përfshirë Njësinë FA/91



K

### 3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese

Sheshi i vënë në dispozicion nga investitori ndodhet në kryqëzimin e rrugës "Haxhi Dushku" me "Rrugen e Elbasanit" dhe autostraden Tirane-Elbasan, në njësinë strukturore FA/91, zona kadastrale 2704, Bashkia Tiranë. Ky shesh përbëhet nga disa prona private, me nr pasurie: 299/4, 300/1, 300/12, 300/13, 300/14, 300/15, 300/16, 300/17, 300/18, 300/19, 300/20, 300/6/4 dhe 300/8 dhe ka një sipërfaqe totale prej 38560 m<sup>2</sup>. Ai kufizohet në lindje nga "Rrugen e Elbasanit", ne jug nga prona me nr. pasurie 438/5, 439/2 dhe në veri nga e rrugës "Haxhi Dushku". Terreni eshte i pjerret, me diferenca te theksuara kuotash.

Në truallin, pronë private, pasuria nr. 299/4, 300/1, 300/12, 300/13, 300/14, 300/15, 300/16, 300/17, 300/18, 300/19, 300/20, 300/6/4 dhe 300/8 e z.k 2704 ku parashikohet të kryhet ndertimi nuk ka asnjë ndertim ekzistues te cilat do te duhet te prishen.

Trualli ndodhet në një zonë me infrastrukturë relativisht të formuar, gjë që favorizon në furnizimin me ujë dhe me energji elektrike të ndërtimit të propozuar.




Fig.04 Rilevimi Topografik i gjëndjes ekzistuese



Kund  
Kund




Fig.05 Foto të gjendjes ekzistuese




Fig.06 Foto të gjendjes ekzistuese



K  
Kushtrim

#### 4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

##### 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara

Objekti i këtij projekti është ndërtimi i një objekti me funksion banimi, i konceptuar si një volum prej 4-5-6 katesh mbi tokë dhe 2,3 kate nëntokë me konstruksion mbajtës prej betoni të armuar.

Ndërtimi i propozuar, është konceptuar që të jetë i aksesueshem përgjatë rrugës "Haxhi Dushku" dhe rruges se Elbasanit.

Nga rruga "Haxhi Dushku" janë parashikuar hyrje-daljet per automjetet, te cilat ne kete rast do te levizin per ne nivelet e poshtme nepermjet rampes se parkimit.

Kompozimi i këtyre banesave duhet të jetë i projektuar në mënyrë që të krijojë një kompleks baneshash që, pavarësisht numrit të apartamenteve, të ketë një ndjenjë 'fshati' dhe të fokusohet në hapësira të gjelbra të mëdha komunitare.

"Lagija e re" duhet të jetë një hapësirë e mbyllur dhe e kontrolluar me një hyrje të jashtme të vetme dhe të ketë një parkim nëntokësor për përdorim privat të njësive të banimit.

Programi i ndërtimit zhvillohet maximalisht deri në 9 kate: 6 kate mbi tokë dhe 3 kate nën tokë. Komunikimi ndërmjet kateve zgjidhet nga bërthama vertikale të vendosura ne cdo modul banimi.

Dy grupet e apartamenteve janë të përqendruara në perimetrin e jashtëm të parcelës për të maksimizuar hapësirën e lirë, të hapur, ku njerëzit mund të bëjnë një shëtitje në kafene ose përreth hapesirave te gjelberta. Lartësitë e ulëta të ndërtesave i përshtaten topografisë në mënyrë shumë të respektueshme, duke ndjekur konturin e tokës natyrore për të krijuar një dialog ku të gjithë elementët plotësojnë njëri-tjetrin.

Objektet janë te projektuara ne 15 nivele te ndryshme, me lartesi kati 3.35m, ku terreni percakton funksionin e ndertimit. Niveli i katit me te ulet fillon ne kuoten absolute 185.00 m dhe arrin kuoten me te larte 235.25 m.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be the initials "K" followed by a more complex, cursive name.




Fig.8 Planimetria e objektit verior në Kuotën +198.40



K




Fig.9 Planimetria e tarraces e objektit ne veri ne Kuoten + 235.25



Kamil




Fig.10 Planimetria e objektit jugor në Kuotën + 205.10




Fig.11 Planimetria e tarraces ne Kuoten + 208.45



*Kunash*

#### 4.2 Shperndarja e kateve

Objektet pozicionohen ne shesh ne formen e nje blloku i cili eshte paralel me konturin e prones, ne menyre te tille qe le gjelberim ne te gjitha anet ne pjesen e jashtme, por qe formon nje oborr te brendshem dhe privat ne lidhje me hapesiren qe mbetet brenda.

Duke qene se reliivi i terrenit ne te cilin pozicionohet eshte me pjerresi te theksuar, shperndarja e kateve nuk eshte e njetrajtshme. Kjo do te thote qe ne pjese te caktuara te objektit, fasada perceptohet nga 4 deri ne 6 kate.

#### 4.3 Pamja e Jashtme e Godines / Oborri

Ndërtimi i propozuar përfaqëson një objekt me volumetri unik i cili shfaqet i hapur përgjatë Unazës se Madhe, autostrades Tirane-Elbasan dhe rrugës "Haxhi Dushku", nga ku janë parashikuar edhe hyrje daljet kryesore në të.

Fasada e Jashtme

Fasada e jashtme është një mur i vazhdueshëm, si një "fortesë". Kjo jo vetëm që i jep një vlerë të shtuar ndërtesës, por gjithashtu krijon një imazh të fortë bashkëkohor dhe një ndjenjë përkatësie tek banorët.

Fasada e brendshme / Oborri

Faqja e brendshme e ndërtesave ka një personalitet të veçantë, me pamje nga peizazhi i gjelbëruar, është plotësisht i hapur. Secila nga 400 njësitë gëzon komoditetin e një shtëpie fshati, me orientim dhe ajrim të shkëlqyer dhe me një nivel të lartë privatësie midis fqinjëve.

Në këtë mënyrë propozohen 2 kopshte te medha te brendshëm me lloje të ndryshme pemësh tipike përvendin, i cili do të ndihmojë në balancimin e kontrollit diellor dhe klimatik të ndërtesës.

Objekti tjeter ne mes te kopeshtit te objektit verior, do jete nje objekt sherbimi me funksion BAR-KAFE. Ky lokacion i përgjigjet mundësisë që ky objekt të shfrytëzohet bashkërisht si nga banoret e objektit ne veri, ashtu dhe ne jug.




Fig.12 Pamje nga Veri-Perendimi e objektit ne veri



K




Fig.13 Pamje nga Jug-Perendimi e objektit ne veri




Fig.14 Pamje nga Jug-Lindja e objektit ne veri




Fig.15 Pamje nga Veri-Lindja e objektit ne veri



Kuqja



Fig.16 Prerja BB' e objektit ne veri




Fig.17 Prerja AA' e objektit ne veri




Fig.18 Pamje nga Veri-Perendimi e objektit ne jug



Kushen




Fig.19 Pamje nga Jug-Perendimi e objektit ne jug




Fig.20 Pamje nga Jug-Lindja e objektit ne jug




Fig.21 Pamje nga Veri-Lindja e objektit ne jug



Kurde




Fig.22 Prerja AA' e objektit ne jug




Fig.23 Prerja BB' e objektit ne jug

#### Ndertimi dhe materialiteti

Për të arritur një kontrast në të gjithë kompleksin, ndërtimi i godinave te banimit do te ndjeke trajtim te ndryshem nga i Universitetit ne pjesen e perparme. Për kete shkak, ndërtesa është projektuar duke përdorur një strukturë kolonash dhe soletash të forta prej betoni të armuar. Hapësira ndërmjet kolonave do të jetë e masave që lejojnë një trashësi të reduktuar të soletes dhe nuk sjellin investim në strukturën jo standarde.

Fasadat e jashtme janë të pajisura me konstruksion tradicional të dy ndarjeve me tulla te lehtesuara me vrima me izolim me kapote dhe finitura perfundimtare me suva te bardhe, kurse fasada e brendshme pervec elementeve te siper permendur do te kete dhe elementin horizontal te betonit ne dukje.

Dyshemetë do tëjenë të vazhdueshme me beton te niveluar dhe do të përfshijnë të gjitha shtresat e nevojshme izoluese.

Tarraca do të jetë e rrafshët dhe e realizuar me një zgjidhje konstruktive standarde me shtresë zhavorri dhe me panele foto-voltaike.



*Kuçi*



Fig.24 Pamje e Fasades kryesore



Fig.25 Pamje e Fasades se brendshme



Kuril

Tavanet e të gjitha hapësirave do të janë solete betoni strukturore, e ekspozuar dhe e lyer.

Carjet e fasadës do të jene prej alumini. Në fasadat me pamje nga parku dhe me xham të plotë, vendoset panele xhami fikse të ngulitura në dysheme dhe tavan dhe dy dritare për ajrim.

Perde prej pëlhure veprojnë si elementë të kontrollit diellor në lidhje me mbivendosjen e soletave nga xamat e lustrimit.

Të gjithë elementët e punimeve metalike, si parmakët, do të janë prej çeliku të lyer.



Fig.26 Pamje e Interierit



Km



Fig.27 Pamje e Oborrit



Fig.28 Pamje e fasades se brendshme



K

#### 4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit

#### TREGUESIT E ZHVILLIMIT:

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	38560 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	13371.26 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë:	68033.92 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit nën tokë:	40960.35 m <sup>2</sup>
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	34.7 %
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapsira publike	65.3 %
Intensiteti i ndërtimit:	1.76
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	22 m
Numri i kateve mbi tokë:	4, 5, 6 kate
Numri i kateve nën tokë:	2-3 kate

#### TREGUES TEKNIK:

Zona Kadastrale: Z.K. 2704; Nr. pasurie: 299/4, 300/1, 300/12, 300/13, 300/14, 300/15, 300/16, 300/17, 300/18, 300/19, 300/20 , 300/6/4, 300/8

#### Kufizimet:

Veri:	Rruja "Haxhi Dushku",
Jug:	Pas.Nr. 438/5, 439/2
Lindje:	"Rruja e Elbasanit",
Perëndim:	Pas.Nr. 299/3.

#### Distancat nga kufiri i pronës:

Veri	min 4.7m - max 9.1m
Lindje	min 5.1m - max 9.5m
Jug	min 4.9m - max 22.2m
Perëndim	min 4.5m - max 33.5m

#### Distancat nga aksi i rrugës:

Veri:	min 14.7m - max 18.4m
Lindje:	min 9.1m - max 9.9m



#### 4.5 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta

Siq u tregua më parë, konturi i oborrit përcaktohet nga vendosja e hapësirave të ndryshme që formojnë programin funksional të ndërtesës, të cilat kanë një shumëlojshmëri të gjerë dimensionesh për të rritur fleksibilitetin e përdorimit të ndërtesës.

Lidhja e kësaj ideje me synimin për të ruajtur topografinë ekzistuese sikur të ishte një pjesë e tokës natyrore e paprekur nga ndërtimi, na lejon të kemi marrëdhënie të shumta e të ndryshme midis ndërtesës dhe peizazhit të saj të brendshëm.

Në këtë mënyrë propozohet një oborr i madh i brendshëm me lloje të ndryshme pemësh tipike përvendin, i cili do të ndihmojë në balancimin e kontrollit diellor dhe klimatik të ndërtesës.




Fig.29 Plani i Sistemimit



*[Handwritten signature]*

## 5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

### 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

Ky projekt nuk prezanton asnjë ndryshim apo propozim të ri per infrastrukturen rrugore. Respekton plotësisht gjendjen ekzistuese, si edhe propozimin e planit të ri të bashkisë Tiranë, përsa i përket, rrjetit të infrastruktures rrugore që ka zona e interesit.

Objekti do te pajiset me te gjithe infrastrukturen inxhinierike të nevojshme, e cila do të jetë e lidhur me infrastrukturën ekzistuese të zonës. Ndërtimi i këtij objekti nuk do të ndikojë në devijimin e infrastrukturës inxhinierike ekzistuese. Objekti do të plotësojë nevojat e tij për ujë higjeno-sanitar dhe energji elektrike nëpermjet shfrytëzimit të rrjetit ekzistues. Përsa i përket sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza, ato do te lidhen me kanalizimet ekzistuese në zonë.

Aksesi sigurohet nga rrugët ekzistuese “Haxhi Dushku”. Nga rruga do të behet i mundur hyrja në pronë me automjete. Gjithashtu në rast emergjence, automjeti zjarrfikes ka askes në të paktën 2 anë të sheshit për shuarjen e zjarreve eventuale.

Mbetjet e ngurta do te menaxhohen në bashkëpunim me Bashkine Tiranë, dhe do të përcaktohet vendi i depozitimit të tyre, para marrjes se Çertifikates së Përdorimit. Pastrimi i mbetjeve urbane do të kryhet nëpërmjet vendosjes së koshave të jashtëm të mjaftueshëm, ndërkohe që evakuimi i mbetjeve do te kryhet nga firma pastruese e zonës.






Fig.30 Planvendosje e Përgjithshme



Kurk